

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe pikës 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm, Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nxjerr dhe dorëzon menaxhmentit të lartë të komunës dhe komitetit të auditimit këtë:

STATUT TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KOMUNËN E DEÇANIT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Në bazë të nenit 18 të Ligjit 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik është përgjegjës për zbatimin dhe funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm në pajtim me kërkesat e këtij ligji.

Neni 2

Njësia e Auditimit të Brendshëm është pjesë e administratës së Komunës së Deçanit.

KAPITULLI II

KOMPETENCAT E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 3

Njësia e Auditimit të Brendshëm i ushtron kompetencat e veta në përputhje me Ligjin nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Neni 4

Çdo ndryshim i ligjit 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike lidhur me kompetencat e Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të zbatohen menjëherë pas hyrjes në fuqi gjatë punës së njesisë.

Neni 5

Rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, kodin e etikës dhe standardet profesionale për ushtrimin e auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm përgatiten nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm dhe miratohen nga Ministri i Financave.

KAPITULLI III

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

Neni 6

Qëllimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është të ofroj shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë operacionet e organizatës. Ai i ndihmon organizatën që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Neni 7

Fushëveprimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është që të përcaktoj nëse rrjeti i organizatës për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes siç është dizajnuar dhe përfaqësuar nga menaxhmenti, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë të siguroj që:

- a). Rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen si duhet;
- b). Informata të mjaftueshme financiare, menaxheriale dhe operative të jenë të sakta, të besueshme dhe me kohë;
- c). Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes të ndodhë sipas nevojës;
- d). Burimet të sigurohen në mënyrë ekonomike, të përdoren me efikasitet dhe të mbrohen në mënyrë adekuate;
- e). Veprimet e punonjësve të jenë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e aplikueshme;
- f). Të arrihen programet, planet dhe objektivat;
- g). Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm të promovohet në procesin e kontrollit të organizatës;
- h). Çështjet e rëndësishme legjislative ose rregulloret që kanë ndikim në organizatë të jenë pranuar dhe adresuar si duhet;

Neni 8

Mundësitë për përmirësimin e kontrollit të menaxhmentit dhe imazhit të organizatës që mund të identifikohen gjatë auditimeve. Ato do të komunikohen te nivelet adekuate të menaxhmentit (Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit).

Neni 9

NJAB-ja, gjatë auditimit bënë grumbullimin e informacioneve duke përdorur burime të ndryshme si nga Dosjet e përhershme për organizatën, burimet e identifikuar në takimin fillestar nga menaxhmenti i organizatës që auditohet etj.

Neni 10

Fushëveprimi ose periudha që auditohet nga NJAB-ja për njësinë e auditimit do të përcaktohet paraprakisht bazuar në planin vjetor dhe strategjik dhe do të auditohet në varësi prej shkallës së rrezikut të cekura në Planin Strategjik të NJAB-së duke përfshirë

edhe periudhën deri në momentin e fillimit të auditimit për vitin kalendarik që auditohet dhe ndahet sipas koeficientëve së rrezikshmërisë gjithnjë sipas gjasës dhe ndikimit nëse ndodhë ai rrezik.

- a) Rrezik i ulët (koeficienti 1 deri 1.70).
- b) Rrezik i mesëm (koeficienti 1.71 deri 2.30) dhe
- c) Rrezik i lartë (koeficienti 2.31 deri 3.00).

KAPITULLI IV

LLOGARIDHËNIA

Neni 11

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e detyrave të tij/saj do të jetë llogaridhënës ndaj Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), në nivel qendror që të:

- a). Ofroj për çdo vit vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e proceseve të organizatës për kontrollimin e aktiviteteve të saja dhe menaxhimin e rreziqeve të saja në fushat e vëna nën misionin dhe fushëveprimin e punës;
- b). Raportoј çështjen e rëndësishme që ndërlidhen me proceset për kontrollimin e aktiviteteve të organizatës dhe partnerëve të saj, përfshirë edhe përmirësimet potenciale të atyre proceseve dhe ofrimin e informatave për sa i përket çështjeve të tilla nëpërmjet zgjidhjeve;
- c). Ofroj periodikisht informatat mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të NJAB-ës.
- d). Koordinoj dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimi i rrezikut, pajtueshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

KAPITULLI V

PAVARËSIA

Neni 12

Auditori është i pavarur në punën e tij/saj, dhe janë të mbrojtur nga ndërhyrjet sipas nenit 21 të Ligjit 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Neni 13

Për t'i dhënë pavarësi Njesisë së Auditimit të Brendshëm, personeli i tij (Auditorët) i raportojnë Drejtorit të NJAB-ës i cili/a administrativisht i raporton Kryetarit të Komunës dhe funksionalisht Komitetit të Auditimit dhe NJQHAB-së në mënyrën e parashtruar në seksionin e mësipërm Llogaridhënia.

Neni 14

Si pjesë e raportimit të tij/saj te Komiteti i Auditimit do të përfshijë edhe një raport të rregullt mbi personelin e auditimit të brendshëm.

KAPITULLI VI

PËRGJEGJËSIA

Neni 15

Drejtori i NJAB-ës dhe Auditorët e Brendshëm kanë përgjegjësinë që të:

- a). Hartojnë një plan fleksibil vjetor të auditimit të brendshëm, duke përdorur metodologjinë adekuate që bazohet në rrezik, përfshirë çfarëdo shqetësimi për rrezik ose kontroll të identifikuar nga menaxhmenti dhe të dorëzoj këtë plan te Kryetari i Komunës dhe komiteti i auditimit për rishikim dhe miratim;
- b). Dorëzojë planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm tek NJQHAB-jo më vonë se deri më 31 Dhjetor te secilit vitë kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë dhe komiteti i auditimit.
 - Zbatoj planin vjetor të auditimit siç është miratuar përfshirë edhe ndonjë detyrë (auditim) që kërkohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit;
 - . Mbjaj personel profesional të auditimit me njohuri të mjaftueshme shkathtësi, përvojë, dhe certifikim profesional për të përmbushur kërkesat e këtij statuti;
 - Themeloj programin e sigurisë të cilësisë me anë të së cilit Drejtori i NJAB-ës siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm;
 - Kryej shërbime këshillëdhënëse, përtej shërbimeve të auditimit të brendshëm për siguri, të asistoj menaxhmentit në arritjen e objektivave të tija. Shembujt mund të përfshijnë lehtësimin, dizajnimin e procesit , trajnimin dhe shërbimet këshillëdhënëse;
 - Lëshoj raporte periodike për komitetin e auditimit dhe kryetarin komunës duke përmbledhur rezultatet e aktiviteteve të auditimit;
 - Ofroj një listë të synimeve dhe rezultateve të rëndësishme të matjes për komitetin e auditimit dhe kryetarin e komunës;
 - . Asistoj në hetimin e aktiviteteve të rëndësishme të dyshuara për mashtrim brenda organizatës dhe të njoftoj Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit për rezultatet;
 - Të merret parasysh fushëveprimi i punës së auditorëve të jashtëm siç duhet, për qëllim të ofrimit të mbulimit optimal të organizatës me auditim me një kosto të arsyeshme të përgjithshme.
 - Mirëmbajtja dhe ruajtja e të gjitha dosjeve të raporteve të auditimit, shënimeve gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmiqe që kanë të bëjnë me ato raporte, dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmentit të organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njërive shpenzuese, menaxhmentit të lartë dhe komitetit të auditimit së paku për shtatë (7) vite.

Neni 16

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm cakton ekipin e auditimit dhe udhëheqësin e ekipit të auditimit.

Neni 17

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet ta rishikoj dhe ta nënshkruaj raportin përfundimtar dhe ta dërgoj atë tek menaxhmenti i organizatës buxhetore dhe komitetit të auditimit.

Neni 18

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), përkatësisht auditorët e brendshëm gjatë auditimit duhet t'i zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara sipas standardeve, udhëzimeve, doracakëve dhe dokumenteve tjera të vendosura nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) dhe të aprovuara nga Ministri i Financave.

KAPITULLI VII

AUTORITETI

Neni 19

Drejtori i NJAB-ës dhe Auditorët e Brendshëm janë të autorizuar që të:

- a). Kenë qasje të pa kufizuar në të gjitha funksionet, të dhënat , pronat dhe personelin;
- b). Kenë qasje në Komitetin e Auditimit;
- c). Alokoj burimet, vendos frekuencat, përzgjedhë temat, përcaktoi fushëveprimin e punës t'i zgjeroj ato dhe aplikoi teknikat e kërkuara për të arritur objektivat e auditimit;
- d). Marr asistencën e nevojshme të personelit në njësitë e organizatës ku ata kryejnë auditimet, si dhe shërbimet tjera të specializuara nga brenda organizatës ose jashtë saj.

Neni 20

Drejtori i NJAB-ës dhe Auditorët e Brendshëm nuk janë të autorizuar që të:

- a). Kryejnë ndonjë detyrë operative për organizatën ose partnerët e saj;
- b). Inicioj ose miratoi transaksionet e kontabilitetit që janë jashtë departamentit të auditimit të brendshëm
- c). Drejtoj aktivitetet e punonjësve të organizatës që nuk janë punësuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm , përveç deri në atë shkallë kur punonjësit e tillë janë caktuar në ekipin e auditimit si duhet, ose ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar auditorët e brendshëm.
- d). Dhe ndalesat tjera sipas nenit 26 të Ligjit nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm te Financave Publike.

KAPITULLI VIII

KOHËZGJATJA E AUDITIMIT

Neni 21

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të përcaktoj numrin e ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuara sipas planit strategjik për ciklin tre vjeçar.

Neni 22

Varësisht nga koeficienti i rrezikut për sistemet e identifikuara koha standarde për auditime është;

- a). Sistemet me rrezik të lartë – 30 ditë për vit për tërë ekipin e auditimit (pra 90 ditë për një sistem gjatë ciklit tre vjeçar);
- b). Sistemet me rrezik të mesëm – 20 ditë për vitin e radhës (pra 40 ditë për një sistem gjatë periudhës tri-vjeçare të);
- c). Sistemet me rrezik të ulët – 25 ditë për një cikël të auditimit.

Neni 23

Ndarja e kohës së nevojshme për secilin auditim individual për fazat; planifikim të auditimit, puna në teren, raportimi dhe përcjellja bëhet në bazë të klasifikimit të rrezikshmërisë së sistemit që auditohet.

KAPITULLI IX

KOMUNIKIMI DHE FORMAT E RAPORTIMIT

Neni 24

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të komunikoj rezultatet e angazhimit për secilin auditim.

Neni 25

Komunikimi duhet të jetë objektiv, i qartë, konciz, me kohë dhe konstruktiv.

Neni 26

Komunikimi duhet të përfshijë objektivat dhe fushëveprimin e angazhimit, konkluzionet, rekomandimet dhe planet e veprimit që janë të zbatueshme.

Neni 27

Qëllimi kryesor i raportit të auditimit është të informohet Zyrtari Kryesor Administrativ dhe menaxhmenti për rezultatet e auditimit, për të:

- a). Dhënë një vlerësim të gjendjes së procesit të audituar, duke shprehur mendim të

- pavarur dhe objektiv për efektivitetin e procedurave të kontrollit që ka të bëjë me ligjshmërinë, menaxhimin e mirë financiar dhe transparencën; dhe
- b). Dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit për të korrigjuar çdo gabim, dobësi dhe parregullsi të identifikuar nga auditimi.

Neni 28

Pas kryerjes së fazës të auditimit që ka të bëjë me punën në teren hartohet draft raporti i auditimit. Draft raporti i auditimit duhet të:

- a). Përgatitet nga anëtarët e ekipit të auditimit; dhe
- b). Rishikohet nga udhëheqësi i ekipit të auditimit, pas kryerjes së punëve në teren. Pas rishikimit, rangimi i përgjithshëm duhet të diskutohet me Drejtorin e NjAB-së.

Neni 29

Draft raporti duhet ti dorëzohet menaxhmentit të organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar, me qëllim që të merren përgjigjet (komenteve) e tyre rreth rekomandimeve të dhëna.

Neni 30

Menaxhmenti i organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar në afat prej dhjetë (10) ditë pune nga dita e marrjes së draft raportit të auditimit është i obliguar që t'i japin përgjigjet (kometet) e tyre në rekomandimet e draft raportit të auditimit.

Neni 31

Posa të merren të gjitha përgjigjet e menaxhmentit të organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar, raporti duhet të rishikohet nga udhëheqësi i ekipit të auditimit i cili ka për detyrë që:

- a). Çdo gabim faktik të vërejtur nga menaxhmenti, duhet të korrigjohet dhe të gjeturat dhe rekomandimet që kanë pasur mungesë të dëshmisë së mjaftueshme mbështetëse në draft raport duhet të fshihen.
- b). Ekipi i auditimit të brendshëm duhet të qëndroj pranë të gjeturave dhe rekomandimeve të veta për të cilat menaxhmenti nuk ka siguruar fakte të mjaftueshme të cilat do të ndikonin në objektivitetin e auditorëve rreth të gjeturave dhe rekomandimeve në draft-raportin e auditimit. Aty ku ka dëshmi dhe analiza të mjaftueshme, nuk duhet të lejoj që të bjerë nën presionin e menaxhmentit dhe të lëshoj një raport jo adekuat të auditimit.

Neni 32

Pas kalimit të afatit prej 10 ditësh të përcaktuar në nenin 30 të këtij statuti duhet të përpilohet raporti përfundimtar nga anëtarët e ekipit duke marrë parasysh:

- a). Në rastin kur merren përgjigjet nga menaxhmenti i organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar, këto përgjigje duhen të inkorporohen në raportin final dhe dokumentet përcjellëse të raportit; dhe
- b). Në rastin kur nuk merren përgjigjet nga menaxhmenti i organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar, konsiderohet se menaxhmenti ka pranuar rekomandimet dhe si i tillë draft raporti bëhet raport (final) përfundimtar.

Neni 33

Raporti përfundimtar duhet që:

- a). Të rishikohet nga udhëheqësi i ekipit të auditimit;
- b). Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet ta rishikoj dhe ta nënshkruaj raportin përfundimtar dhe ta dërgoj atë tek menaxhmenti i organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese të audituar, Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit.

Neni 34

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm përgatit dhe dorëzon raportet tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm tek menaxhmenti i lartë, Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) dhe Komitetit të Auditimit.

Neni 35

Raportimin e menjëhershëm tek menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i Auditimit, për çdo indikator të aktivitetit të mashtrimit apo korrupsionit dhe dhënien propozimeve për përmirësimin e sistemeve si dhe njoftimin e autoriteteve kompetente, nëse menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik nuk ndërmerr veprime të duhura;

Neni 36

Raportet e përpiluara si rezultat i angazhimeve konsultuese apo hetimet e posaçme audituese për mashtrime të dyshuara, parregullësi apo korrupsion do të jenë shumë konfidenciale dhe më formale sesa raportet tjera, që kërkojnë kujdes të veçantë dhe ndjeshmëri në përfundimin dhe zgjidhjen e tyre.

KAPITULLI X STANDARDET E PRAKTIKËS SË AUDITIMIT

Neni 37

Aktivitetet e auditimit të brendshëm të Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, të vendosura nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), si dhe në pajtim me parimet e sjelljes të Kodit të Etikës.

Neni 38

Qëllimi i standardeve është që të:

- a). Bëjnë identifikimin parimeve bazë, të cilat janë udhëzues të praktikës së auditimit të brendshëm;
- b). Ofrojnë kornizën për kryerjen e një vargu të gjatë të aktiviteteve të auditimit të brendshëm që e shtojnë vlerën;
- c). Vendosin bazat për vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm; dhe

d). Ndihmojnë përmirësimin e veprimeve dhe proceseve të organizatës.

Neni 39

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), do të përmbushë ose tejkaloj Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm.

KAPITULLI XI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT TË LARTË TË KOMUNËS PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Neni 40

Menaxhmenti i lartë i komunës duhet:

- a). të sigurojë që Auditimi i Brendshëm ka burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe të tjera për ushtrimin efikas të detyrave dhe përgjegjësisë të tij.
- b). të sigurojë ndërmarrjen e masave të shpejta dhe efektive për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, Auditori i Brendshëm, Komiteti i Auditimit dhe NJQHAB;
- c). të eliminojë parregullsitë e zbuluara gjatë auditimit si dhe zbatimin e masave për të parandaluar parregullsitë e tilla në të ardhmen;
- d). të sigurojë që organizata buxhetore i përmbush të gjitha kushtet e parapara të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm; dhe
- e). të sigurojë që të gjithë shërbyesit civil dhe personat e punësuar apo të angazhuar nga organizata buxhetore ose ndonjë njësi tjetër që :
 - mundësojë Njesisë së Auditimit të Brendshëm qasje të lirë në të gjitha dokumentet, shënimet, zyrat dhe pasurit që janë të nevojshme për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre; dhe
 - ndërmarrin masa aktive për të asistuar dhe për të lehtësuar punën e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.

KAPITULLI XII REKRUTIMI, KUALIFIKIMI DHE TRAJNIMI I AUDITORËVE TË BRENDSHËM

Neni 41

Rekrutimin e personelit për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, organizata buxhetore e bënë sipas legjislacionit mbi shërbyesit civil dhe kushteve të parapara në neni 22 të Ligjit nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Neni 42

Në komisionin e rekrutimit të Drejtorit për Njësinë e Auditimit të Brendshëm duhet të marrë pjesë një përfaqësues nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB).

Neni 43

Kualifikimi, trajnimi dhe licencimi i personelit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm bëhet sipas nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

KAPITULLI XIII

KUFIZIMI NE PUNENE E AUDITORËRVE TË BRENDSHËM DHE KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 44

Kufizimet në punën e auditorëve të brendshëm

1. Auditorët e brendshëm në punën e tyre janë të paanshëm, objektiv dhe raportojnë për çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit. Në lidhje me këtë auditorët e brendshëm:

1.1. nuk përfshihen në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të subjektit të sektorit publik;

1.2. nuk mbajnë poste politike, nuk janë anëtarë aktivë të ndonjë subjekti politik dhe nuk emërohen në pozita drejtuese në strukturat e subjekteve politike; dhe

1.3. nuk kryejnë angazhime auditimi për dhënien e sigurisë lidhur me funksionet, veprimtaritë dhe strukturat për të cilat ata kanë dhënë shërbime këshilluese ose në të cilat kanë qenë të punësuar gjatë periudhës së kaluar dy (2) vjeçare.

Konflikti i interesit

2. Në rastet kur ka konflikt të interesit apo dyshohet për mundësinë e ndodhjes së konfliktit të interesit, i paraparë si i tillë me legjislacionin në fuqi, dhe i cili mund të paraqitet si rezultat i auditimit, atëherë auditori i brendshëm detyrohet që të njoftojë me shkrim drejtorin e njesisë apo personin kompetent në institucion. Pas njoftimit për një konflikt të tillë, apo mundësinë e ndodhjes, drejtori i njesisë së auditimit apo personi kompetent, me qellim të shmangies së një veprë të tillë cakton auditorin e brendshëm në detyra tjera.

2.1 Konflikti i interesit, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin e përgjithshëm, ekziston nëse:

2.2. auditori i brendshëm ka punuar gjatë dy (2) viteve të fundit për subjektin që do të auditohet dhe për të cilin ka përcaktuar, vendosur dhe hartuar procedurat për sistemet ose proceset që janë subjekt i auditimit brenda vitit të kaluar

KAPITULLI XIV

MARRËDHËNIET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM ME AUDITORIN E JASHTËM

Neni 45

Zyra e auditorit të përgjithshëm kryen auditime të jashtme në pajtushmëri me ligjin dhe rregulloret dhe aktet nënligjore të Kosovës.

Neni 46

Drejtori i secilës njësitë auditimit të brendshëm është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve me auditorin e jashtëm (në shumicën e rasteve, auditori i jashtëm është Zyra Kombëtare e Auditorit).

Neni 47

Qëndrimi i kooperimit dhe bashkëpunimit, përshkruan marrëdhënien ideale të Njesisë së Auditimit të Brendshëm me auditoret e jashtëm. Kjo marrëdhënie, e jo ajo e cila auditimin e brendshëm e konsideron si një vazhdim të rolit të auditimit të jashtëm, është e nevojshme për shkak të dallimit në objektiva. Auditorët e jashtëm kryesisht janë të interesuar në ekzaminimin vjetor që merr formën e verifikimit të asetëve dhe detyrimeve në datën e caktuar dhe analizat e tilla të pasqyrave të të hyrave do t'ju mundësojnë atyre që të shprehin opinionin për saktësinë e pasqyrave financiare.

KAPITULLI XV MARRËDHËNIET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM ME KOMITETIN E AUDITIMIT

Neni 48

Komiteti i Auditimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm mbështeten në mënyrë reciproke. Njësia e Auditimit të Brendshëm mbështetë komitetin në çështjet në vijim:

- a). Rishikimi i linjave raportuese funksionale dhe administrative të njësisë së auditimit të brendshëm në kuadër të organizatës, për të siguruar se mirëmbahet pavarësia e tyre;
- b). Vlerësimi i përshtatshmërisë së personelit, përshtatshmërisë financiare dhe të burimeve të tjera në dispozicion për njësinë e auditimit të brendshëm;
- c). Të siguruarit se nuk bëhet asnjë kufizim i burimeve apo fushëveprimit që do të pengonte aktivitetet e auditimit;
- d). Sigurimi i raporteve të cilat përmbledhin aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe drejtimi i vëmendjes së komitetit në dobësitë e mëdha të sistemeve, rreziqeve dhe parregullsive operacionale;
- e). Përcjellja e performansës së njësisë së auditimit të brendshëm në krahasim me planin vjetor të auditimit;
- f). Raportimi me kohë i aktiviteteve joligjore, mashtruese apo korruptuese dhe
- g). Sigurimi i vlerësimit të kualitetit të auditimit të brendshëm.

Neni 49

Komiteti i Auditimit mbështetë Njësinë e Auditimit të Brendshëm duke plotësuar përgjegjësitë në vijim:

- a). Të siguruarit se karakteri i auditimit të brendshëm është i përshtatshëm;
- b). Shqyrtimi i planeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për të vërtetuar së planet janë të përshtatshme me rrethanat e entitetit të sektorit publik. (Në veçanti të siguruarit se planet reflektojnë ekspozimin e organizatës ndaj rrezikut dhe nuk janë të influencuara nga menaxhmenti);

- c). Janë në dispozicion për Njësine e Auditimit të Brendshëm për qëllime të eskalimit të brengave kur nuk është vepruar sipas rekomandimeve të auditimit dhe
- d). Promovimi dhe mbrojtja aktive e pavarësisë së funksionit të auditimit të brendshëm në kuadër të entitetit të sektorit publik.

Neni 50

Komunikimi efektiv në mes të Komitetit të Auditimit dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm është me rëndësi vendimtare për këtë marrëdhënie.

Disa aktivitete kyçe të komunikimit janë:

- a). Takimet në mes të komitetit dhe drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm;
- b). Raportet përmblledhëse periodike të aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe
- c). Raporti vjetor për aktivitetet e auditimit

KAPITULLI XVI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 51

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të statutit me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-121 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dispozitat e ligjit mbizotërojnë.

Neni 52

Ky statut hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Drejtori i NJAB, Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Drejtori i NJAB-së:



Sami Gjokaj

Kryetari i Komunës



z. Bashkim Ramosaj

Kryesuesi i Komitetit të Auditimit



z. Jeton Demukaj

Deçan- më, 23/01 /2020